



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 14 qershor 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Gani Geci, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Radmila Vujović.

Munguan: Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Selviqe Halimi dhe Mufera Şinik (ishte në udhëtim zyrtar).

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lavdim Krasniqi – drejtor i IGJK-së, Petrit Hysaj – OSBE, Isuf Zejna - KDI, Sanije Berisha – OSBE, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 qershorit 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Komisionit Funkcional në Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 qershorit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 7 qershor 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2009

Kryetari – E përshëndeti drejtorin e IGJK-së, z. Lavdim Krasniqi. Tha se Raporti ka ardhur pak me vonesë, jo pse Instituti nuk ka pasur mundësi ta procedonte me kohë, por për arsye të mungesës së Bordit të Këshillit Drejtues. Shtoi se Raporti është hartuar mirë, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë teknik, që dallon nga raporti i vitit të kaluar. Ishte i mendimit se në Raport është dashur të përfshihej sfida që ka pasur Instituti lidhur me mandatin e anëtarëve të Këshillit Drejtues. Pyeti: *A janë paguar anëtarët e Këshillit Drejtues për kohën pas skadimit të mandati?* Fjalën ia dha z. Lavdim Krasniqi ta paraqiste Reportin.

Lavdim Krasniqi – drejtor i IGJK-së - E paraqiti Reportin. Ceku se është miratuar më 12 maj 2010 nga Këshilli Drejtues. Theksoi se ndër programet e trajnimit të realizuara në vitin 2009 është edhe Programi i vazhdueshëm për arsimimin ligjor të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Numri i aktiviteteve ishte më i madh se në vitin e kaluar (101 aktivitete). E paraqiti një përmbledhje të këtyre aktiviteteve të realizuara në vitin 2009 nga IGJK-ja. Në vazhdim foli për Programin fillestar për arsimimin ligjor, për brezat, që kanë i ndjekur trajnimet në modulet të trajnimit, duke i specifikuar siç ishin realizuar këto module nga Instituti.

Për pyetjen e pagesës së anëtarëve të Këshillit Drejtues, tha se nuk janë paguar, sepse paguhen në bazë të takimeve që i realizojnë.

Ibrahim Makolli - Për mandatin e anëtarëve të Këshillit Drejtues tha se nuk është faji vetëm i Institutit, por edhe i Kuvendit. E përgëzoi Institutin për punën në trajnimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Shtoi se është një raport i mirë, që i plotëson kushtet që të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në Kuvend.

Adem Hajdaraj - Tha se është një raport i hartuar mirë në pikëpamje teknike. Për trajnimet tha se po zgjasin shumë. Megjithatë kandidati e ka dhënë provimin e judikaturës, përsëri duhet t'u nënshtrohet këtyre trajnimeve, që sipas tij janë të gjata. Trajnimet e organizuara në Programin e vazhdueshëm për arsimimin ligjor janë të përshtatshme për aftësimin e kandidatëve, por duhet të jenë më të shkurtra, sepse kanë shpenzime, si për kandidatët ashtu edhe për Institutin.

Armend Zemaj - Kërkoj sqarim nga drejtori i IGJK-së për provimin përgatitor, sepse thuhet se këta kandidatë marrin diplomë, jo certifikatë. Në këtë aspekt a keni biseduar me institucionet e tjera, si me gjykatën apo me Ministrinë e Arsimit, që kjo të jetë një lloj akademie për gjyqtarë dhe ç'është paraparë për këtë çështje?

Sqarime shtesë lidhur me vërejtjet dhe me pyetjet e shtruara nga anëtarët e Komisionit dha z. Lavdim Krasniqi.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet nga Kuvendi i Kosovës Raporti i punës i Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2009.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryetari – I paraqiti propozimamendamentet e Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Kërkoj deklarimin e anëtarëve mos kishin ndonjë vërejtje për propozimamendamentet.

Gani Geci - Duke folur për Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, propozoi që në titullin e Projektligjit pas fjalëve: “Mbikëqyrës të”, të shtohet fjala “Republikës” dhe të riformulohet: “Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës”.

Pas propozimit të dhënë nga Gani Geci, diskutuan edhe Ibrahim Makolli dhe Armend Zemaj.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni i shqyrtoi propozimamendamentet në Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe vlerësoi se amendamentet e propozuara kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

5 . Të ndryshme

Komisioni e shqyrtoi Raportin e Komisionit për Punë të Jashtme për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 44 për Ministrinë e Punëve të jashtme dhe për Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës nr. 03/L-207.

Komisioni vlerësoi se propozimamendamenti i Komisionit FunkSIONAL ka bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni